

Nga: Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN Kosova)

Për: Ministrin e Mbrojtjes, z. Rrustem Berisha

Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN Kosova) në kuadër të bashkëpunimit me Ambasadën Britanike është duke punuar në inkurajimin e institucioneve publike për të rritur nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.

Në fund të vitit të kaluar, BIRN Kosova e ka prodhuar një analizë të raporteve të auditimit të Ministrisë e Mbrojtjes. Përveç analizave janë mbajtur edhe disa debate nëpër komuna, ku ka marrë pjesë edhe Zyra Kombëtare e Auditimit, të cilët kanë ofruar asistencë institucioneve në hartim të planeve për zbatimin të rekomandimeve, të cilën ndihmë ju inkurajojmë që ta shfrytëzoni.

Në këtë shkresë janë pasqyruar rekomandimet e përsëritura nëpër vite dhe çalimet në fusha specifike. Të bashkangjitura i keni edhe rekomandimet e dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

Duke marrë parasysh se punët në zbatimin e rekomandimeve janë në përfundim, kjo letër është sinjalizim shtesë për rëndësinë e zbatimit të plotë të rekomandimeve apo fillimin e zbatimit të rekomandimeve që marrin më shumë se 1 vit për t'u zbatuar.

Më poshtë gjeni vetëm disa prej shumë rekomandimeve që keni marrë nga Auditori.

- *Ministri duhet të kërkojë nga personat përgjegjës që të inicojnë procedurat për rekrutim për plotësimin e këtyre pozitave me stafit të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor.*
- *Ministri duhet të kërkojë nga personat përgjegjës shtim të kontrolleve dhe të fokusit në këtë pjesë të procesit të prokurimit, në mënyrë që të përmbushen kërkesat e rregullave të prokurimit dhe për të evituar vonesat eventuale në realizimin e projekteve të caktuara.*
- *Ministri duhet të përmirësojë nivelin e kontrolleve në mënyrë që vlerësimi dhe realizimi i projekteve të bëhet brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj.*

Ne do të vijmë në një vizitë në institucionin tuaj për të biseduar për telashet që i keni në zbatim të rekomandimeve si dhe për të parë secilin rekomandim se në cilën fazë është aktualisht: është realizuar plotësisht, është në proces të zbatimit apo nuk është zbatuar fare.

ANEKS

Rekomandimet e Auditorit për Ministrinë e FSK-së, që janë pjesë e raportit të Auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin e përfunduar me datën 31 dhjetor 2017.

Nr.	Rekomandimet e Auditorit në raportin e Auditimit për PVF - 31.12.2017	Plotësisht	Në proces	Të pa-adresuara
1	Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar për projektet kapitale.			
2	Ministri duhet të kërkojë nga personat përgjegjës që të inicojnë procedurat për rekrutim për plotësimin e këtyre pozitave me stafit të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor.			
3	Ministri duhet të kërkojë nga personat përgjegjës shtim të kontrolleve dhe të fokusit në këtë pjesë të procesit të prokurimit, në mënyrë që të përmushen kërkesat e rregullave të prokurimit dhe për të evituar vonesat eventuale në realizimin e projekteve të caktuara.			
4	Ministri duhet të iniciojë një vlerësim të progresit rreth realizimit të planit të veprimit, për të identifikuar barrierat që po pengojnë zbatimin e rekomandimeve dhe të përcaktojë masat e nevojshme për tejkalimin e këtyre barrierave			
5	Ministri duhet të sigurojë që lista e rreziqeve, po monitorohet në vazhdimësi, në baza tremujore, për të reduktuar ndikimin në nivele të pranueshme, si dhe të merren veprimet e duhura, në rastet kur janë të nevojshme, për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.			

Nr.	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016 (Të evidentuara në fund të raportit të auditimit për 2017)	Plotësisht	Në proces	Të pa-adresuara
1	Ministri duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Për rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.			



2	Ministri duhet të përmirësoj nivelin e kontrolleve në mënyrë që vlerësimi dhe realizimi i projekteve të bëhet brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj.			
---	---	--	--	--